

DEKRET
Nr.6201, datë 8.6.2009

**PËR CAKTIMIN E KOMPETENCAVE TOKËSORE TË GJYKATAVE TË
RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË QENDRËS SË USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË TË SECILËS PREJ TYRE**

(Ndryshuar me dekretin nr. 7847, datë 3.12.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 6, paragrafi 3 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Ministrit të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen në 22 rrethe gjyqësore, me kompetencë tokësore dhe qendra të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, si më poshtë:

1.Gjykata e rrethit gjyqësor Berat, me kompetencë tokësore në rrethet Berat, Skrapar e Kuçovë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Berat.

2.Gjykata e rrethit gjyqësor Dibër, me kompetencë tokësore në rrethet Bulqizë e Dibër dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Peshkopi.

3.Gjykata e rrethit gjyqësor Durrës, me kompetencë tokësore në rrethin Durrës dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin e Durrësit.

4.Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan, me kompetencë tokësore në rrethet Elbasan, Gramsh, Librazhd e Peqin dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Elbasan.

5.Gjykata e rrethit gjyqësor Fier, me kompetencë tokësore në rrethet Fier e Mallakastër dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Fier.

6.Gjykata e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, me kompetencë tokësore në rrethet Gjirokastrë e Tepelenë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Gjirokastrë.

7.Gjykata e rrethit gjyqësor Kavajë, me kompetencë tokësore në rrethin Kavajë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Kavajë.

8.Gjykata e rrethit gjyqësor Korçë, me kompetencë tokësore në rrethet Devoll, Kolonjë e Korçë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Korçë.

9.Gjykata e rrethit gjyqësor Krujë, me kompetencë tokësore në rrethin Krujë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Krujë.

10.Gjykata e rrethit gjyqësor Kukës, me kompetencë tokësore në rrethet Kukës e Has dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Kukës.

11.Gjykata e rrethit gjyqësor Kurbin, me kompetencë tokësore në rrethin Laç dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Laç.

12.Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë, me kompetencë tokësore në rrethet Lezhë e Mirditë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Lezhë.

13.Gjykata e rrethit gjyqësor Lushnjë, me kompetencë tokësore në rrethin Lushnjë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Lushnjë.

14.Gjykata e rrethit gjyqësor Mat, me kompetencë tokësore në rrethin Mat dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Burrel.

15.Gjykata e rrethit gjyqësor Përmet, me kompetencë tokësore në rrethin Përmet dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Përmet.

16.Gjykata e rrethit gjyqësor Pogradec, me kompetencë tokësore në rrethin Pogradec dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Pogradec.

17.Gjykata e rrethit gjyqësor Pukë, me kompetencë tokësore në rrethin Pukë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Pukë.

18.Gjykata e rrethit gjyqësor Sarandë, me kompetencë tokësore në rrethet Delvinë e Sarandë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Sarandë.

19.Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër, me kompetencë tokësore në rrethet Malësi e Madhe dhe Shkodër dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Shkodër.

20.Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, me kompetencë tokësore në rrethin Tiranë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Tiranë.

21.Gjykata e rrethit gjyqësor Tropojë, me kompetencë tokësore në rrethin Tropojë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Bajram Curri.

22.Gjykata e rrethit gjyqësor Vlorë, me kompetencë tokësore në rrethin Vlorë dhe me qendër të ushtrimit të veprimtarisë në qytetin Vlorë.

Neni 2

(Shfuqizuar me dekretin nr. 7847, dt. 3.12.2012)

Neni 3

Dekreti 5350, datë 11.6.2007 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”, shfuqizohet.

Neni 4

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi më 1 shtator 2009.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi